



MBAHET KONGRESI I PARË I SHËNDETËSISË – ADRESIMI I SFIDAVE DHE NEVOJAVE TË SHËNDETIT DHE MIRËQENIES SË FËMIJËVE, ADOLESHENTËVE DHE TË RINJVE

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët mori pjesë në **Kongresin e Parë të Shëndetësisë**, të mbajtur me datë 9 mars, ku u diskutua rreth **rëndësisë së shëndetit mendor të fëmijët, adoleshentët dhe të rinjtë, si dhe sfidat e nevojat e shëndetit dhe mirëqenies**. Ndër të tjera, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, ndau me të pranishmit politikat e mira që qeveria ka ndërmarrë për fëmijët dhe të rinjtë, duke vendosur theksin në **Strategjinë Kombëtare për të Rinjtë 2022-2029**, e cila është hartuar **së bashku me të rinj nga e gjithë Shqipëria** dhe ka qenë tepër efektive, pasi ata kanë përcjellë të gjitha shqetësimet dhe sugjerimet e tyre për shëndetin, duke e cilësuar **mirëqenien e shëndetit si pjesë të rëndësishme të jetës së tyre**.

Përpos hartimit dhe fillimit të zbatimit të strategjisë 8 vjeçare multidimensionale, janë hartuar dhe po zbatohen në kuadër të kësaj strategjie edhe shumë programe për përmirësimin e shëndetit të fëmijët dhe të rinjtë si, **Programi i Ekipeve Sportive**, në kuadër të të cilit këtë muaj po zhvillohen kampionatet në nivel qarku dhe **Programi Jashtë Orarit Mësimor**, i cili ka nisur zbatimin në fund të janarit 2023 në 200 shkolla në të gjithë Shqipërinë.



ZBATIMI I PROGRAMIT JASHTË ORARIT MËSIMOR NË SHKOLLËN "ISMAIL QEMALI", SHKODËR DHE "LEF SALLATA", VLORË.

Në kuadër të **programit Jashtë Orarit Mësimor (JOM)**, i cili nisi zbatimin në fund të muajit janar 2023 **në 200 shkolla në të gjithë Shqipërinë**, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët përgjatë muajit mars zhvilloi një vizitë në shkollën "Ismail Qemali" në Shkodër, si dhe një vizitë në shkollën "Lef Sallata" në Vlorë, për të parë nga afër zbatimin dhe ecurinë e programit. Gjatë vizitës, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, bisedoi me fëmijët që marrin pjesë në kurset e ofruara **pa pagesë nga programi JOM**, duke dëgjuar kështu komentet dhe kërkesat e tyre për aktivitetet e programit, i cili këtë vit shkollor është ende në fazë pilotimi.

Programi JOM aktualisht ofron **1041 kurse tematike falas**, të cilat zhvillohen 2 herë në javë në fushat: **pikturë; muzikë; kor; teatër; zeje; bujqësi dhe mjedis; sport dhe mirëqenie; dhe teknologji**, duke i dhënë kështu mundësi fëmijëve dhe të rinjve për të zgjeruar njohuritë dhe të zhvillojnë talentet e tyre pa asnjë kosto shtesë.



VIJON RRTJJA E BASHKËPUNIMEVE ME BIZNESIN PËR NDËRLIDHJEN ME TREGUN E PUNËS NË KUADËR TË PROGRAMIT E KODIMIT.

Në linjën e takimeve për zhvillimin e mëtejshëm të mbështetjes së ofruar për çdo individ të moshës 16 vjeç e sipër, nëpërmjet **Programit të Kodimit**, i cili çeli aplikimet më 23 janar dhe aktualisht **numëron mbi 2400 aplikime**, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, përgjatë muajit mars, ka zhvilluar disa takime me dhomat e tregtisë, për të biseduar rreth mënyrave të ndryshme të bashkëpunimit.

Së bashku me përfaqësues nga Ambasada Amerikane, Dhoma e Tregtisë Zviceriane në Shqipëri dhe Dhoma e Tregtisë Greke në Shqipëri, biseduan për bashkëpunimet e mundshme në kuadër të Programit të Kodimit. **Mbështetja e qeverisë** në këtë program nuk është vetëm në **anën financiare**, por përfshin edhe **ndërlidhjen me tregun e punës me anë të bashkëpunimit me aktorë të ndryshëm në treg**.



MBAHET ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E CONFINDUSTRIA ALBANIA PËR INOVACIONIN DHE KAPITALIN NJERËZOR NË SHQIPËRI

Më datë 21 mars, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, mori pjesë në **Asambleenë e Përgjithshme të Confindustria Albania për inovacionin dhe kapitalin njerëzor në Shqipëri**, për të diskutuar rreth sfidave aktuale përsa i përket burimeve njerëzore dhe kualifikimit të tyre të vazhdueshëm. U diskutua edhe rreth **politikave që po ndërmerret qeveria shqiptare për të përmirësuar njohuritë e individëve në fushën e teknologjisë**, duke u krijuar kushtet e nevojshme dhe dijet e duhura për të punuar në këtë fushë me paga konkurruese, si në tregun shqiptar, por edhe atë ndërkombëtar.

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët u ndal **tek dy nisma që qeveria po zhvillon me qëllim rritjen e aftësive digjitale të kapitalit njerëzor: Programi i Kodimit në shkollë**, për të krijuar një gjeneratë të re të pajisur me aftësi koduese dhe njohuri bazë digjitale; dhe **Programi i Kodimit**, i cili ofron kurse programimi për çdo individ 16 vjeç e sipër, me mbështetje financiare 50% për studentët, apo të punësuarit dhe 100% për punëkërkuessit e papunë.

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët ftoi kështu edhe sipërmarrësit italianë për të investuar në Shqipëri, pasi numri i individëve që po aplikojnë për kurset e formimit profesional me mbështetje financiare nga qeveria, po rritet dita ditës, duke rritur numrin e profesionistëve në fushën e teknologjisë së informacionit.



MBAHET CEREMONIA E HAPJES SË KAMPIONATIT BOTËROR TË PESHËNGRITJES PËR TË RINJË

Ky vit padyshim është një vit i artë për peshëngritjen dhe sportin në vendin tonë, ku Tirana mban titullin "Qyteti Evropian i Sportit"! **Shqipëria mirëpret për herë të parë në historinë e saj, Kampionatin Botëror të Peshëngritjes për të Rinj**. Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët mori pjesë në ceremoninë hapëse të kampionatit, i cili do të mbahet në qytetin e Durrësit, me pjesëmarrjen e 58 shteteve.

Në këtë triumf historik, shteti ynë do të përfaqësohet denjësisht në Kampionatin Botëror të Peshëngritjes për të Rinj nga 5 të rinj padyshim të njohur dhe të suksesshëm: **Enkileda Carja, Antonino Mullisi, Flavjo Alliaj, Samoel Rrasa** dhe **Mariglen Kofsha**.



ZHVILLOHEN NDESHJET FINALE TË EKIBEVE SPORTIVE NË QARKUN E TIRANËS

Pas një rrugëtimi të gjatë dhe të suksesshëm për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë e përfshirë në **Programin e Ekipeve Sportive**, gjatë këtij muaji janë zhvilluar **finale të qarkun e Tiranës**, në sportin e volejbollit dhe basketbollit, për vajzat dhe djemtë. Në datat 18 dhe 19 mars u zhvilluan ndeshjet finale të volejbollit për shkollat 9-vjeçare dhe gjimnazet, ndërsa në datat 23 dhe 30 mars u zhvilluan ndeshjet finale të basketbollit përkatësisht për gjimnazet dhe shkollat 9-vjeçare. Përgjatë muajit prill do të zhvillohen ndeshjet finale për të gjithë qarqet.

Ditën e shtunë, më 18 mars, u zhvilluan ndeshjet finale të volejbollit midis shkollave 9-vjeçare. Ndeshja finale për djem u zhvillua midis ekipit "Vëllazërimi" të Kamzës dhe "Rilindja" të Kavajës, me **fitoren e ekipit "Vëllazërimi"**, ndërsa ajo për vajza u zhvillua midis ekipit "100 Vjetori" të Kamzës dhe "Vëllazërimi" të Kamzës, me **fitoren e ekipit "100 Vjetori"**.

Ditën e dielë, më 19 mars, u zhvilluan ndeshjet finale të volejbollit për gjimnazet. Ndeshja finale për djem u zhvillua midis ekipit "Qemal Stafa" të Tiranës dhe "Isa Boletini" të Kamzës, me **fitoren e ekipit "Isa Boletini"**, ndërsa ajo për vajza u zhvillua midis ekipit "Qemal Stafa" të Tiranës dhe "Ibrahim Rugova" të Kamzës, me **fitoren e ekipit "Qemal Stafa"**.

Ditën e enjte, më 23 mars, u zhvilluan ndeshjet finale të basketbollit për gjimnazet. Ndeshja finale për djem u zhvillua midis ekipit "Sami Frashëri", Tiranë dhe ekipit "Ibrahim Rugova", Kamzë, me **fitoren e ekipit "Ibrahim Rugova"**, ndërsa ajo për vajza u zhvillua midis ekipit "Sami Frashëri", Tiranë dhe ekipit "Ibrahim Rugova" të Kamzës, me **fitoren e ekipit "Sami Frashëri"**.

Ditën e enjte, më 30 mars, u zhvilluan ndeshjet finale të basketbollit midis shkollave 9-vjeçare. Ndeshja finale për djem u zhvillua midis ekipit "Hillary Clinton", të Kamzës dhe ekipit "Vora" të Vorës, me **fitoren e ekipit "Hillary Clinton"**, ndërsa ajo për vajza u zhvillua midis ekipit "Hillary Clinton" të Kamzës dhe ekipit "Dhora Leka" të Tiranës, me **fitoren e ekipit "Hillary Clinton"**.